

**Kërkesë për bursë financiare, përjashtim nga tarifa e shkollimit në
programet e studimit: me karakter profesional, bachelor, programet e integruara të studimit
Viti akademik 2025 - 2026**

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”

Në mbështetje të Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, VKM-s nr. 903, datë 21.12.2016 ‘Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studenët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar, VKM-s Nr. 269, datë 29.03.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit,” i ndryshuar, VBA-së nr. 62 datë 22.10.2025 “Për miratimin e procedurave dhe shqyrtimin e kërkesave të studentëve “Për përfitim burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2025-2026, të studentëve, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi në; programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit” dhe ngritjen e Komisionit “Ad Hoc””

NJOFTON:

I- Të gjithë studentët e regjistruar **në programet e studimit me karakter profesional, programet bachelor, programet e integruara të studimit (program i parë studimi)**, që plotësojnë kriteret për të përfituar:

A. Bursë financiare dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit

1. Studentët, familjet e të cilëve trajtohen me ndihmë ekonomike.
2. Bashkëshortët, të cilët kanë fëmijë dhe janë të dy studentë.
3. Student, person me aftësi të kufizuara.
4. Student, i cili i ka të dy prindërit me aftësi të kufizuara
5. Student, me prind bashkëjetues pensionist dhe prindi tjetër i është ndarë nga jeta.
6. Student, i cili i ka të dy prindërit pensionistë.
7. Student, i cili është i treti e lart në radhën e fëmijëve në familje me tre fëmijë a më shumë, nga të cilët dy të parët janë studentë në institucionet publike të arsimit të lartë.
8. Studentët që kanë përfituar statusin e jetimit, deri në moshën 25 vjeç.
9. Studentët që kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykatë të formës së prerë, deri në moshën 25 vjeç.
10. Studentët që janë identifikuar si viktime të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë përfituar statusin ligjor për trajtim si viktime të trafikut të qenieve njerëzore deri në moshën 25 vjeç.
11. Studentët fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës.

B. Vetëm përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit

12. Student, i cili ka njërin nga prindërit me aftësi të kufizuara
13. Studentët romë dhe egjiptianë
14. Studentët fëmijë të ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë nga sistemi komunist ose fëmijë me prindër të dënuar politikë me heqje lirie.

II- Studentët të plotësojnë kërkesën duke filluar nga data 27.10.2025 e në vijim, sipas formatit “**DEKLARIM (KËRKESË) PËR PËRFITIM BURSE DHE/OSE PËRJASHTIM NGA TARIFA VJETORE E SHKOLLIMIT PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026**” e cila të shkarkohet në: [www/uniel.edu.al](http://uniel.edu.al), Rubrika/ Zona e studentit/ njoftime dhe ta dërgojnë në adresën: **Zyra e Këshillimit Karrierës dhe ALUMNI/ Korpusi kryesor/ Kati i dytë**

(Plotëso të dhënat e domosdoshme në pozicionin e vijëzuar për kriterin që i përkisni dhe dorëzoje dokumentin e plotësuar , së bashku me dokumentet e kërkuara bashkëlidhur në adresën e cituar më sipër)

III- Për çdo sqarim të nevojshëm për përfitim burse dhe përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit studentët do të kenë specialistë: Zyra e Këshillimit karrierës dhe ALUMNI/ Korpusi kryesor/ Kati i dytë

V.O. Studentët që dërgojnë kërkesat deri me datë 24.12.2025 dhe plotësojnë kriteret e përcaktuara, do të përfitojnë bursë financiare nga data e fillimit të vitit akademik 2025-2026 ose data e regjistrimit në universitet për vitin e parë. Studentët që kanë aplikuar pas kësaj periudhe do të përfitojnë bursë financiare në muajin pasardhës nga data e dorëzimit të kërkesës, sipas përcaktimeve në VKM-t përkatëse.

V.O. Studentët që aplikojnë për herë të parë për përfitim të bursës financiare, të hapin llogari bankare pranë Raiffeisen bank dhe ta bashkëlidhin në kërkesën që do të dorëzojnë, ndërsa studentët që kanë përfituar bursë financiare në vitet e mëparshme të konfirmojnë pranë bankës llogarinë e tyre.

Nuk përfitojnë bursë financiare

Mbështetur në VKM-n nr. 903, datë 21.12.2016 ‘Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studenët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar,

1. Studentët që vazhdojnë studimet në program të dytë studimi (studentët që studiojnë për diplomë të dytë ose kanë mbaruar një shkollë të lartë)
2. Studentët që janë në gjendje civile të ndarë nga trungu familjar
3. Studentët që janë përsëritës (humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluëse)
4. Studentët që nuk janë në vitin normal të studimit (Nuk janë brenda kohëzgjatjes normale të studimit sipas përcaktimeve në aktet normative pra nëse studenti gjatë kohës së studimeve ka qenë përsëritës, në vitin pasardhës nuk fiton bursë)

Nuk përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit

1. Studentët që vazhdojnë studimet në program të dytë studimi (studentët që studiojnë për diplomë të dytë ose kanë mbaruar një shkollë të lartë)
2. Studentët që janë në gjendje civile të ndarë nga trungu familjar,
3. Studentët që janë përsëritës (humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokaluëse)

Formulari (kërkesa) i deklarimit gjendet në adresën www.uniel.edu.al /Zona e studentit/ njoftime

Formulari (kërkesa) i deklarimit për “Për përfitim burse financiare, përjashtim nga tarifa vjetore e shkollimit për vitin akademik 2025-2026, të studentëve, që vazhdojnë studimet në program të parë studimi në; programet e studimit me karakter profesional, programet studimit bachelor, programet e integruara të studimit”, të shkarkohet në adresën www.uniel.edu.al /Zona e studentit/ njoftime

